

MARRËVESHJE FINANCIARE KUSHTET E VEÇANTA

Komisioni Evropian, në vijim i referuar si "Komisioni" ose "pala" e cila vepron në emër të Bashkimit Evropian, në vijim i referuar si "Bashkimi",

nga njëra anë dhe

Mali i Zi i përfaqësuar nga Qeveria e Malit të Zi – Zyra e Integritetit Evropian dhe Republika e Shqipërisë, që në vijim referohen bashkërisht si "Përfituesit e IPA II", ose veçmas si "përfituesja e IPA II" ose "pala",

nga ana tjetër,

dhe bashkërisht të referuara si "Palët"

KANË RËNË DAKORD SI MË POSHTË:

Neni 1 - Programi i Veprimit

1. Bashkimi bie dakord të financojë dhe përfituesit e IPA II bien dakord të pranojnë financimin për alokimet e vitit 2017 të Programit të Veprimit në vijim, siç përshkruhet në Shtojcën I:

Programi i Veprimit të Bashkëpunimi Ndërkufitar Mali i Zi - Shqipëri për vitet 2015 – 2017. (Numri i angazhimit (CRIS): 2017/038-175)

Ky Program Veprimi financohet nga Buxheti i Bashkimit në bazë të aktit themelor në vijim: Instrumenti për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA II)¹.

2. Kostoja e totale e llogaritur për fondet e vitit 2017 të këtij Program Veprimi është 1,400,000 Euro dhe kontributi maksimal i Bashkimit për këtë Program Veprimi është vendosur 1.190.000 Euro.

Nuk kërkohet kontribut financiar nga përfituesit e vendeve IPA II.

Neni 2 - Periudha e ekzekutimit dhe periudha e zbatimit operacional

1. Siç përcaktohet në nenin 1 (1) të Shtojcës II, periudha e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje Financimi është caktuar 12 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

¹ Rregullorja Nr. 231/2014 (BE) e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2014 që krijon një Instrument për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA II), OJ L 77, 15.03.2014, fq. 11.

2. Siç përcaktohet në nenin 1 (2) të Shtojcës II, periudha e zbatimit operacional të kësaj Marrëveshjeje Financimi është caktuar 6 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

Neni 3 - Adresat dhe Komunikimi

I gjithë komunikimi në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshjeje financimi duhet të jenë në formë të shkruar, duke iu referuar shprehimisht Programit të Veprimit siç identifikohet në nenin 1 (1) dhe do të dërgohet në adresat e mëposhtme:

për Komisionin

Znj. Genoveva Ruiz Calavera
Drejtorja D, Ballkani Perëndimor
Drejtoria e Përgjithshme për Negociatat e Zgjerimit dhe
Fqinjësinë, Komisioni European
15, Rue de la Loi, B – 1049 Bruksel,
Belgjikë E-mail: NEAR-D1@ec.europa.eu

për përfituesit e IPA II

Për Malin e Zi:

Znj. Ivana Glisevic Durovic
Zëvendës Krye-Negociatore dhe Koordinatori Kombëtar i IPA-s
Qeveria e Malit të Zi
Zyra e Integritetit Evropian
Bulevardi Revolucije 15
81000, Podgoricë, Mali i Zi
E-mail: ivana.glisevic@mep.gov.me

Për Shqipërinë::

Z. Ditmir Bushati
Koordinatori Kombëtar i IPA-s
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Bulevardi Gjergj Fishta, Nr. 6
Tiranë, Shqipëri
Adresë e-mail-i: info@imfa.gov.al

Neni 4 - Pikat e kontaktit të OLAF

Pika e kontaktit të përfituesit të IPA II që ka kompetencat e duhura për të bashkëpunuar drejtpërdrejt me Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF) në mënyrë që të lehtësojë aktivitetet operative të OLAF-it, do të jenë:

Për Malin e Zi:

AFCOS pikë kontakti / zyra e AFCOS
Znj. Natasa Kovacevic
Ministria e Financave e Malit të Zi
Stanka Dragojevića 2, 81000, Podgoricë, Mali i Zi
Natasa.kovacevic@mif.gov.me

Për Shqipërinë::

Z. Bejko Late
Drejtor i Njësisë së Inspektimit Financiar
Ministria e Financave dhe Ekonomisë të Shqipërisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë, Shqipëri
Bejko.late@financa.gov.al

Neni 5 - Marrëveshjet Kuadër

Programi i Veprimit do të zbatohet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Evropian dhe Malit të Zi mbi marrëveshjet për zbatimin e asistencës financiare të Bashkimit për Malin e Zi nën Instrumentin e Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA II), e cila ka hyrë në fuqi më 04 qershor 2015 dhe në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi marrëveshjet për zbatimin e asistencës financiare të Bashkimit në Shqipëri nën Instrumentin e asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA II), e cila ka hyrë në fuqi më 16 prill 2015, (e referuar në vijim si "Marrëveshja Kuadër (et)").

Kjo Marrëveshje Financimi plotëson dispozitat e Marrëveshjeve Kuadër të lartpërmendura. Në rast konflikti, nga njëra anë, të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje financimi dhe nga ana tjetër, dispozitave të Marrëveshjes Kuadër përkatëse, këto të fundit do të kenë përparësi.

Neni 6 - Shtojcat

(1) Kjo Marrëveshje Financimi përbëhet nga:

- a) këto Kushte të Veçanta;
- b) Shtojca I: Programi i Veprimit CBC Mali i Zi - Shqipëri për vitet 2015, 2016, 2017;
- c) Shtojca IA: Programi IPA II BNK 2014-2020 midis Malit të Zi dhe Republikës së Shqipërisë;
- d) Shtojca II: Kushtet e Përgjithshme;
- e) Shtojca III: Model i Raportit Vjetor BNK për zbatimin e asistencës IPA II në përputhje me nenin 80 të Marrëveshjes Kuadër;

- f) Shtojca IIIA: Modeli i Raportit Vjetor për zbatimin e asistencës IPA II në përputhje me nenin 58 dhe 59 (1) të Marrëveshjes Kuadër;
- g) Shtojca IV: Modeli i Raportit Financiar sipas nenit 59 (2) të Marrëveshjes Kuadër;
- h) Shtojca V: Specifikimet Minimale të Sistemit të Kontabilitetit me Bazë Akruale;
- i) Shtojca VI: Masat ad hoc për besimin e detyrave të zbatimit të buxhetit nën këtë Program.

(2) Në rast të një konflikti, në njërën anë e dispozitave të Shtojcave dhe nga ana tjetër e dispozitave të këtyre Kushteve të Veçanta, këto të fundit do të kenë përparësi. Në rast të një konflikti, nga njëra anë, të dispozitave të Shtojcës I dhe Shtojcës IA dhe e dispozitave të Shtojcës II nga ana tjetër, këto të fundit do të kenë përparësi. Në rast konflikti ndërmjet dispozitave të Shtojcës I, nga njëra anë, dhe dispozitave të Shtojcës IA nga ana tjetër, këto të fundit do të kenë përparësi.

Shtojca VI parashikon masat *ad hoc* për besimin e detyrave të zbatimit të buxhetit nën këtë Program, përveç detyrave të përfituesit IPA II që është Autoriteti Kontraktues në lidhje me besimin e detyrave të zbatimit të buxhetit të parashikuar në këtë Marrëveshje Financiare.

Neni 7 - Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Financimi do të hyjë në fuqi ditën që do të nënshkruhet nga pala e fundit, në rastin më të vonë, deri më 31 dhjetor 2018.

Kjo Marrëveshje hartohet në gjuhën angleze në tre kopje, një kopje i dorëzohet Komisionit dhe një kopje secilit prej përfituesve të IPA II.

Për përfituesin IPA II:

Për Komisionin:

Për Malin e Zi:

Znj. Genoveva Ruiz Calavera

Znj. Ivana Glisevic Durovic
Zëvendës Krye-Negociatore
dhe Koordinatori Kombëtar i IPA-s
Qeveria e Malit të Zi
Zyra e Integritetit Evropian

Drejtor i Drejtorisë D, Ballkani Perëndimor
Drejtoria e Përgjithshme për Negociatat e Zgjerimit
dhe Fqinjësinë
Komisioni Evropian

Bruksel, Datë

Podgoricë, Datë

Për Shqipërinë::

Z. Ditmir Bushati

Koordinatori Kombëtar i IPA-s

Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme

Koordinatori Kombëtar i IPA-s

Tiranë, Datë